



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 405 , datë 13.5.2015



P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.50, DATË 5.2.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN
E STRATEGJISË PËR PARANDALIMIN DHE SHLYERJEN
E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA E TË PLANIT
TË VEPRIMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.160/2014, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2015", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pas pikës 7, të shkronjës "A", "Hyrje dhe të dhëna paraprake", të Strategjisë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura e të planit të veprimit, miratuar me vendimin nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1. Në kuadër të Strategjisë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura, do të trajtohen edhe kërkesat e paraqitura në institucionet buxhetore për shlyerjen e detyrimeve për vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë pas datës 31.12.2013, por që procesi i gjykimit dhe vendimi i shkallës së parë të gjykimit është përpara datës 31 dhjetor 2013."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE

SHKËLQIM CANI